




“Vlerat e Trashëgimisë Kulturore” në një Panair

Qendra Kulturore Mediatike Antigones (QKMA), në kuadër të ECSRA-s, realizoi projektin “Trashëgimia Kulturore në Shërbim të Edukimit, Zhvillimit Ekonomik e Social”, duke patur në fokus sensibilizimin e komunitetit dhe strukturave vendore, mbi rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Aktivitetet e parashikuara ishin botimi i gazetës “Antigonea”, shpërndarja e disa posterave dhe fletëpalosjeve, një varg tryezash debati me pjesëmarrje të gjerë dhe një anketim për zhvillimin turistik të zonës. Ky projekt kishte si qëllim që nëpërmjet veprimtarive ndërgjegjësuese, sensibilizuese dhe promovuese, të bëjë të mundur përmirësimin e partneritetit dhe metodave të mirëqeverisjes për rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit të banorëve të komunës së Antigonesë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Kjo ka si qëllim vënien e zonës në interes të zhvillimit ekonomik/social, përmirësimin e bashkëpunimit midis komunitetit, bizne-

sit dhe administratës së komunës. Ndër objektivat specifike mund të përmendet ndërgjegjësimi i komunitetit për vlerat e trashëgimisë kulturore e natyrore ku ata jetojnë dhe si mund ta shfrytëzojnë ata këtë për të përfutur të ardhura. Nga ana tjetër, u synua edhe ndërgjegjësimi i strukturave të qeverisjes vendore që veprojnë në terren, për nevojën dhe mënyrat e menaxhimit të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.



Ylli MUHO
Kryetar i Komunës
Antigonë,
Gjirokastrë



“Duke u bërë partner dhe pjesë e iniciativës së Qendrës Kulturore Mediatike Antigone, më duhet të theksoj se programe të tilla janë me vlera të jashtëzakonshme për të zgjuar komunitetet e mbuluara nga apatia dhe varfëria, por jo nga vlerat njerëzore, traditat dhe vlerat e trashëgimisë kulturore. Në komunën tonë jetojnë bashkarisht shqiptarë të krishterë të zonës etnografike të Lumçerisë, shqiptarë lebër kryesisht blegtorë të ardhur nga malësitë e Kurveleshit, popullsi arumune ose vllebe vendosur këtu rreth viteve 60, por edhe të tjerë si xagoritë, përmetarë, e minoritarë greke. Natyrisht ata janë një pasuri e madhe njerëzore dhe etnokulturore që me projekte të tilla ngacmohen dhe zgjohen. Projekti i Qendrës Kulturore Antigone synoi pikërisht të nxirrte në pah vlerat e jashtëzakonshme të trashëgimisë kulturore që kjo zonë ka. I ftoj të gjithë këta partnerë që të forcojmë më tej bashkëpunimin në projekte të tjera edhe më të plota në të ardhmen...”

Elbasan: Qendra “ShBE” në mbështetje të grave rurale

Qendra “Shërbimet Bujqësore Elbasan” (ShBE) përfundoi me sukses aktivitetet e saj në kuadër të projektit ECSRA. Projekti i saj “Sensibilizimi për ngritje kapacitetesh për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje dhe formimi profesional i tyre në Komunitat Shirgjan, Belësh dhe Gostimë” pati si qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit mbi rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje. Projekti synonte ngritjen e kapaciteteve dhe aftësitë e tyre profesionale përgjithësisht në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.

Në fokus ishte ndërgjegjësimi i grave/vajzave për të drejtat e tyre dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive në proceset vendimmarrëse. Paralelisht iniciativat e parashikuara targetonin edhe komunitetin e burrave/djemve në zonat ku u shtri projekti, si dhe strukturat e qeverisjes lokale, duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë e forcimit të rolit të gruas në komunitet duke përmirësuar statusin e tyre social dhe ekonomik. Projekti konsistoi në realizimin e 6 takimeve sensibilizuese ku u diskutua mbi Strategjinë

Kombetare dhe Planin i Veprimit për Barazimin e Gjinore si dhe dhe legjislacioni në fuqi. Më tej u zhvilluan 9 trajnime profesionale në fushën e veterinarisë dhe agronomisë.



Inkurajimi i diversitetit kulturor në Përmet

Promovimi i dialogut dhe harmonisë mes komuniteteve që jetojnë në vendin tonë, mbetet një nga detyrat primare të shoqërisë civile në kuadër të progresit dhe integritetit evropian. Një temë të tillë në kuadrin e programit ECSRA, manaxhoi për periudhën Shtator - Nëntor 2012 edhe CIOFF, Seksioni Shqiptar në Qarkun e Gjirokastrës, duke patur si aktorë kryesorë minoritetin grek dhe pakicat kulturore e grupet etnike që jetojnë në këtë hapësirë gjeografike. Projekti u zhvillua mbi përvojën pozitive disa vjeçare që evidentohet në qytetin e Përmetit.

Projekti bëri pjesë të tij të rinj të shkollave të mesme në organizimin e një konkursi eseistik me temë “Të ndryshëm, por të barabartë”. Mbi 32 të rinj, promovuan humanizmin e tyre social, goditën fenomene të pabarazisë dhe inkurajuan dialogun mes tyre. Në takimet e zhvilluara në Përmet, pjesëmarrësit pavarësisht etnisë që përkisnin, u ballafaquan, miqësuan dhe përcollën mesazhe miqësie, dialogu dhe humanizmi në gjuhën e tyre amtare. Projekti sensibilizoi për një organizim më të mirë të shoqatave që promovojnë trashëgiminë e këtyre pakicave në rajonin juglindor.



BERAT

Një nismë për forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile

Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Grave Qytetare dhe Fshatare”, Berat në kuadër të nismës ECSRA zhvilloi projektin e saj me fokus forcimin e kapaciteteve të OJQ-ve rurale dhe institucioneve të qeverisë lokale në Berat, në mënyrë që të përmiresojnë shërbimet e ofruara për komunitetin. Gjatë muajit të parë të realizimit të projektit u realizuan takime me shoqatat joqeveritare që veprojnë në rajonin e Beratit



dhe përfaqësues të qeverisjes vendore. Këto takime patën si qëllim prezantimin me projektin dhe përcaktimin e pjesëmarrësve që do të përfitojnë nga paketa e trajnimeve. Gjatë këtyre takimeve u realizua një prezantim i shkurtër i tematikave që do të trajtohen gjatë trajnimeve dhe aktiviteteve të mëtejshme, që do të organizohen në kuadër të këtij projekti. Aktivitetet kryesore përfshinin trajnime me organizatat lokale të shoqërisë civile dhe pushtetin vendor, në Qarkun Berat mbi dy tema: “Zhvillimin Organizativ dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore” dhe “Menaxhimin e Projekteve”. Në trajnimin mbi “Zhvillimin Organizativ dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore”, morën pjesë përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues nga strukturat e qeverisë lokale. Pjesmar-



rësit morën njohuri më të plota lidhur me zhvillimin e strukturave organizative, të transparencës dhe etikës institucionale. Gjatë trajnimit mbi “Menaxhimin e Projekteve”, u realizua rritja e aftësive profesionale dhe praktike në shkrimin dhe menaxhimin e projekt-propozimeve, si për organizatat joqeveritare edhe për institucionet e pushtetit vendor. Implementimi i këtij projekti ishte një investim në zhvillimin institucional, leadershipin, menaxhimin e projekteve dhe të programeve si dhe ndërtimin e rrjeteve dhe partneriteteve.

“Tjetër Vizion” për gratë në rrethin e Elbasanit

Shoqata “Tjetër Vizion” në Elbasan në kuadër të nismës “ECSRA”, mbajti aktivitetet e saj mbi rritjen e rolit dhe bashkëpunimit mes Klubeve të Grave në komunat Gjergjan, Gostimë dhe Shushicë. Projekti synoi



të promovonte mekanizmat e bashkëpunimit dhe dialogut mes Klubeve të Grave si dhe të ndërtojë kapacitete dhe nxisë iniciativat në rrjet, nëpërmjet shkëmbimit të praktikave më të mira dhe trajnimeve. Në këtë kuadër u realizuan disa veprimtari ku mund të veçohen takime koordinuese dhe trajnime me anëtarët e Klubeve të Grave të komunave Gjergjan, Gostimë dhe Shushicë. Tematikat që u mbuluan gjatë këtyre takimeve ishin: “Diskriminimi – këndvështrimi social dhe ligjor i këtij fenomeni me fokus gratë”; “Të



drejtat e njeriut me fokus gruan, roli aktual i gruas në zonat rurale”; “Buxhetimi me pjesëmarrje në komunat Gjergjan, Gostimë dhe Shushicë”. Ndërkohë me pjesëmarrjen e rreth 60 grave të këtyre klubeve u zhvillua edhe “Panairi i Ideve”.

LEZHË

AEEM : Skema mbështetëse për Komunën Kallmet

Qendra për Menaxhimin Agro-Mjedisor & Ekonomik (AEEM) në kuadër të ECSRA-s realizoi nismën për “Monitorimin dhe vlerësimin e politikës së mbështetjes direkte të zhvillimit bujqësor në qarkun e Lezhës”. Ky projekt u realizua në



partneritet me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe ekspertëve të politikave në Ministrinë e Bujqësisë dhe Drejtorisë Rajonale në rrethin e Lezhës, ekspertë të pushtetit lokal etj.

Me anë të zbatimit të kësaj iniciative u realizuan disa veprimtari si takime me aktorët e përfshirë në studim (fermerë, ekspertë të politikave bujqësore, ekspertë të pushtetit lokal etj); studimi dhe analizimi i situatës (mbledhje të dhënash, përgatitja e pyetësorëve, realizim intervistash, takime të hapura); ndërtimin dhe përpunimi i bazës së



të dhënave përgatitja e raportit përfundimtar dhe publikimi i rezultateve (tetor – nëntor 2012). Një ndër iniciativat e parashikuara në kuadër të ECSRA-s, ishte edhe diskutimi i hapur organizuar në datën 9 Nëntor 2012, mbi problemet dhe vështirësitë gjatë aplikimit të zbatimit të skemave të mbështetjes në komunën Kallmet.



ECSRA: Viojnë aktivitetet përmblylëse në nivel kombëtar

Pas përmblyljes me sukses të fazës së implementimit dhe monitorimit e vlerësimit të iniciativave të mbështetura në kuadër të ESCRA-s, në fazën përmblylëse të projektit pritet të zhvillohen dy aktivitete kryesore:

1. Botimi i një libri mbi zbatimin e iniciativës, praktikën e krijuar dhe arritjet dhe eksperiencat më të mira të saj
2. Konferenca përmblylëse e ESCRA-s

LIBRI I ARRITJEVE

Libri i arritjeve është një prej dokumenteve më të rëndësishëm të planifikuar për t'u përgatitur dhe botuar në kuadër të aktiviteteve të ESCRA. Ai do të ketë si qëllim pasqyrimin e plotë të iniciativës, arritjet kryesore të saj, eksperiencat dhe praktikën më të mira të krijuara si dhe një reflektim dhe rekomandime për vazhdimësinë e punës në mbështetje të zhvillimit të shoqërisë civile në zonat rurale dhe pjesëmarrjes qytetare në zhvillimin e këtyre zonave. Libri do të organizohet rreth 4 komponentëve kryesorë:

Së pari, një kapitull do t'i dedikohet përshkrimit të ESCRA-s duke përfshirë qëllimin dhe objektivat e saj, procesin e ndjekur, veprimtaritë e zbatuara si dhe aktorët dhe përfituesit e nismave në kuadër të këtij projekti. Së dyti, do të përmbajë një kapitull mbi kontekstin socio-ekonomik të zonave të targetuara nga projekti si dhe grupeve të synuara. Së treti, libri do të sjellë në mënyrë sintetike dhe analitike arritjet dhe impaktin e këtyre iniciativave në raport me punën e bërë nën komponentët e vlerësimit të nevojave, ndërgjegjësimit,



ngritjes së kapaciteteve, dhe ndarjes së eksperiencave dhe advokimit. Botimi do të përmbajë eksperiencat më të mira të identifikuar nga procesi monitorues dhe vlerësues duke shërbyer si praktika të mira dhe shembuj për vazhdimësinë e nismës

Potenciali turistik i Gjinarit në nismat e ECSRA-s

Shoqata e Burimeve Natyrore të Komunës Gjinar (SHBN) një OJF mjedisore që operon në këtë pikë turistike Gjinar në rrethin Elbasanit, ndërmorri nismën "Turizmi dhe Tradita të Ndërthurura për një Zhvillim të Qëndrueshëm". Kjo nismë kishte për qëllim nxitjen e banorëve për të qenë sa më aktiv në shpalosjen e vlerave natyrore dhe tradicionale të kësaj pike turistike. Aktivitetet përfshinin banorët e moshave të ndryshme të kësaj komune, nga brezi i ri deri tek moshë e tretë. Afati i zbatimit ishte tre muaj dhe kishte në plan zhvillimin e aktiviteteve me banorët e komunës me qëllim aktiviz-

KONFERENCA KOMBËTARE

Projekti ESCRA do të përmbyllet me një konferencë kombëtare e cila do të shërbejë jo vetëm si event përmblylës, por edhe si një aktivitet advokacie për fuqizimin e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike si dhe për promovimin e qytetarisë aktive dhe pjesëmarrjes në këto zona. Pjesë e konferencës do të jenë përfaqësuesit më të lartë të politikëbërjes në fushën e zhvillimit rural dhe barazisë gjinore, përfaqësues nga komuniteti i donatorëve, aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe vendor, përfitues të pushtetit vendor dhe komunitetit të biznesit. Konferenca do të synojë të dalë me rekomandime konkrete për fuqizimin e mëtejshëm të shoqërisë civile në zonat rurale, nxitjen e zhvillimit rural me pjesëmarrje dhe për vetë strategjinë e re të zhvillimit rural në Shqipëri.

Ky aktivitet njëkohësisht do të funksionojë si një mundësi takimi për të gjithë aktorët kryesorë të zhvillimit të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike duke ballafaquar në këtë mënyrë arritjet e deritanishme si dhe sfidat konkrete që shtrohen për të ardhmen. Konferenca Kombëtare do të shënojë dhe mbylljen e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të projektit "Forcimi dhe Mbështetja e Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike"



imin e tyre për t'u bërë pjesë e vendim-marrjes dhe shpalosur traditat kulturore si dhe për të dhënë sugjerime për zhvillimin e turizmit në Gjinar. Zbatimi i nismës filloi me një aktivitet në lartësinë 1300m, ku u zhvillua një festë fetare tradicionale. Më tej u zhvilluan takime me banorët e Gjinarit ku ju kërkua të ndanin mendimet rreth zhvillimit të zonës. Aktivitet ishin një mundësi diskutimi për pjesëmarrësit se si ata mund të arrijnë një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit dhe njëkohësisht shpalosjen e traditave dhe vlerave kulturore. Aktivitete të tjera ishin guida natyrore nëpër natyrën e mrekullueshme të Gjinarit turistik, takime nëpër fshatra, fushata ndërgjegjësimi, pastrim e mjedisit, trajnime të nxënësve nëpër shkollat e mesme dhe nëntëvjeçare të komunës etj.



Projekti "Fuqizimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike" (ECSRA) hyri në një fazë ku gjithmonë e më tepër po shijohen frytet e iniciativës së ndërmarrë. Mbarëvajtja dhe suksesi i aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të ESCRA-s është realizuar përmes misionëve monitorues që IDM dhe PNUD Albania kanë ndërmarrë për të parë dhe vlerësuar nga afër ecurinë e nismave të mbështetura në Berat, Elbasan, Lezhë dhe Gjirokastrë. Procesi i monitorimit përfshiu monitorime të drejtpërdrejta, me vizita në aktivitete të planifikuara në kuadër të nismave të ndërmarra, monitorime përmes dokumentacioneve relevante si dhe përmes kontakteve elektronike, si dhe aplikim të fletëve të monitorim-vlerësimit. Pjesë e monitorimit ishin si

ECSRA: Vazhdon monitorimi i zbatimit të nismave në nivel vendor

komponentët e aktiviteteve e realizimi i objektivave, ashtu edhe komponentët financiarë. Më poshtë po përshkruajmë disa nga këto eksperiencat monitorimi në terren.

Skuadrat monitoruese, përbërë nga dy përfaqësues të IDM dhe një përfaqësues nga PNUD Albania, ndoqën nga afër realizimin e aktivitetit përmblylës së Forumit të Gruas Elbasan. Ai konsistoi në një tryezë konsultimi midis pushtetit vendor dhe komuniteti të komunës Shushicë. Vëmendje e veçantë iu kushtua çështjeve të barazisë gjinore dhe grave, nevojave specifike të tyre, dhe mundësive për një përfshirje më të madhe të grave në proceset vendim-marrëse në të ardhmen. Aktiviteti u karakterizua nga një pjesëmarrje e gjerë e grave dhe burrave të komunitetit, si dhe e përfaqësuesve të komunës. Përmes diskutimeve konstruktive mbi gjetjet e një procesi të vazhdueshëm konsultativ, u arritën në një sërë rekomandimesh për të cilat përfaqë-

suesit e pushtetit vendor, pjesëmarrës në takim, u angazhuan t'i bëjnë pjesë të axhendës së tyre për të ardhmen. Ndërkohë në Rajonin e Lezhës gjithashtu u realizuan monitorimet e 5 projekteve të implementuara në kuadër të ESCRA-s. Tematika e objektivat projekteve synojnë mbështetjen e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike për promovimin e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit të zonës. Monitorimet shënojnë dhe fazën e fundit të implementimit të këtij projekti kombëtar.



AARHUS mobilizon të rinjtë e Përmetit



Qendra e Informacionit AARHUS në Vlorë realizoi në kuadër të ECSRA-s nismën: "Eko-Klubet Rinore – Një shembull për mbrojtjen e mjedisit". Qëllimi i këtij nismën ishte ndërgjegjësimi i rinisë dhe qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit. Projekti i drejtohej të rinjve dhe të re-jave, studentëve e aktivistëve mjedisor të rrethit të Përmetit përfshirë Këlcyrën, Ballabanin, Petranin dhe Piskovën. Projekti nisi me krijimin e 5 Eko-Klubeve Mjedisore me të rinj si dhe qytetarë ak-

tivë, dashamirës të mjedisit. Anëtarët e Eko-Klubeve organizuan takime me përfaqësues të pushtetit lokal për të patur një ndikim sa më të madh gjatë aktiviteteve të pastrimit që u zhvilluan. Ndërkohë nga ana e pushtetit lokal u siguruan mjetet për largimin e thasëve me mbeturina të grumbulluara nga studentët e Eko-Klubeve. Në mbyllje, në qytetin e Përmetit u organizua një takim me pjesëmarrjen e anëtarëve të Eko-Klubeve nga Përmeti, Këlcyra, Ballabani, Petrani dhe Piskova.